

Kodi i etikës dhe mirësjelljes në biznes



JOYSON
SAFETY SYSTEMS

PASQYRA E LËNDËS

Misioni dhe vizioni ynë 2

Parimet tona udhëheqëse 3

Mesazh nga udhëheqësit
ekzekutivë 4

Kodi ynë 5

Qëllimi dhe vështrimi i përgjithshëm 5

Kush duhet ta respektojë këtë kod 5

Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret 6

Zyra e Pajtueshmërisë – Burimi juaj 6

Përgjegjësitë e punonjësve 6

Përgjegjësitë shtesë të mbikëqyrësve 7

Bërja e zgjidhjeve të duhura –
Udhëzimet tona për vendimmarrje
etike 8

Parashtrimi i pyetjeve dhe raportimi i
shqetësimeve 8

Politika jonë e moshak marrjes 10

Llogaridhënia dhe disiplina 10

Heqja dorë nga të drejtat dhe ndryshimet
në kod 10

Promovimi i një vendi pune të
sigurt dhe respektues 11

Diversiteti, mundësitë e barabarta dhe
mosdiskriminimi 11

Një vend pune ku nuk ka ngacmime 12

Mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm 14

Alkooli dhe drogat 15

Dhuna në vendin e punës 15

Puna me klientët dhe partnerët tanë
afaristë 16

Marrëveshjet e ndershme dhe të drejta 16

Marrëdhëniet me furnitorët 17

Mbrojtja e të dhënave konfidenciale të palëve
të tjera 17

Ruajtja e integritetit të të dhënave tona 17

Konflikti i interesit 19

Dhuratat dhe zbavitja 20

Ruajtja e të dhënave dhe asetëve 22

Ruajtja e asetëve të kompanisë sonë 22

Të dhënat konfidenciale dhe pronësia intelektuale 23

Përftimi i inteligjencës konkurruese 24

Krijimi dhe menaxhimi i të dhënave të biznesit
tonë 25

Komunikimi me publikun 26

Përdorimi i medieve sociale 26

Ndjekja e letrave dhe frymës së ligjit 27

Parimet “antitrust” dhe konkurrenca e ndershme 27

Bashkëpunimi me auditorët 29

Privatësia e të dhënave 29

Veprimtaritë politike 30

Spekulimi me informacion të brendshëm 31

Lufta ndaj korrupsionit dhe rryshfetit 31

Parandalimi i pastrimit të parave 33

Importet, eksportet dhe tregtia globale 33

Në shërbim të më të mirës 35

Respektimi i të drejtave të njeriut 35

Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve dhe
mineraleve në zonat e konflikteve 35

Mbrojtja e mjedisit 36

Mendimet përmbyllëse të zyrtarit tonë të
pajtueshmërisë 37

Misioni dhe vizioni ynë

Vizioni ynë është të jemi lider botëror në sigurinë e udhëtimit me automjete. Ne përpiqemi të ofrojmë zgjidhjet më cilësore dhe më të besueshme të sistemeve të sigurisë, të cilat iu mundësojnë klientëve tanë të kenë lirinë dhe besimin e duhur për të ngarë brezin e ri të automjeteve të transportit. Këtë e arrijmë duke:

Krijuar një ekip, nëpërmjet përdorimit të kulturës frymëzuese

Qenë partner i fuqishëm dhe i qëndrueshëm i klientëve tanë “OEM” në nivel global

Ofruar produkte të shkëlqyera, të ndërtuara në bazë të inovacioneve në fushën e sigurisë së integruar

U zotuar për cilësi dhe respektim të rregullave e ligjeve

Ofruar një strukturë fleksibile dhe konkurruese të kostove



Parimet tona udhëheqëse

Parimet tona udhëheqëse janë udhërrëfyese ynë. Ato përshkruajnë mënyrën se si do ta arrijmë ne vizionin tonë dhe përforcojnë zotimin tonë për t'i kryer veprimtaritë tona afariste me integritet.

Zotimi për të respektuar etikën dhe integritetin në çdo gjë që bëjmë

Respektimi i etikës dhe integritetit janë në qendër të mënyrës se si i realizojmë ne aktivitetet tona afariste. Ne caktojmë standarde të larta të sjelljes etike dhe presim nga punonjësit tanë që t'i respektojnë këto standarde dhe të veprojnë në pajtim me “Parimet udhëheqëse”, madje edhe në rrethana sfiduese. Ne presim që të gjithë punonjësit tanë të jenë të sinqertë dhe transparentë gjatë kryerjes së aktiviteteve afariste dhe të kenë kurajën për të bërë gjënë e duhur.

Zotimi për cilësinë

Ne krenohemi me ofrimin e produkteve dhe shërbimeve tepër cilësore të sigurisë për klientët tanë. Ne zotohemi të respektojmë standardet e cilësisë, të përcaktuara nga klientët tanë, grupet industriale dhe agjencitë qeveritare. Ne përpiqemi çdo ditë të përmirësojmë cilësinë që ofrojmë dhe të ruajmë mendësinë e përmirësimit të vazhdueshëm në çdo gjë që bëjmë.

Llogaridhënia

Ne besojmë në llogaridhënie. Llogaridhënia nënkupton që ne mbajmë përgjegjësi për veprimet tona dhe për veprimet e ekipeve tona. Në rast se shkelim standardet dhe vlerat tona, ne marrim masat për t'i korrigjuar me shpejtësi gabimet apo situatat e papërshtatshme. Llogaridhënia nuk ka të bëjë me fajësimin apo gjetjen e fajtorit; ajo nënkupton respektimin e vlerave tona, “Kodi i etikës dhe mirësjelljes në biznes” dhe të politikave tona.

Ngritja e zërit

Ne e vlerësojmë mjedisin ku “ngrihet zëri”. “Ngritja e zërit” nënkupton parashtrimin e pyetjeve në mënyrë që të sigurojmë që po iu përmbahemi standardeve të larta që ia kemi caktuar vetes dhe partnerëve tanë të biznesit. Ne i nxisim punonjësit tanë “të ngrenë zërin” kur mendojnë se ka pasur shkelje të ligjit, “Kodit të etikës dhe mirësjelljes në biznes” apo politikave të kompanisë. Duke “ngritur zërin”, ju na ndihmoni të mbrojmë brendin dhe reputacionin tonë. Ne mbështesim një kulturë ku punonjësit tanë ndihen rehat kur ngrenë problematikat apo bëjnë pyetje pa pasur frikë se mos kompania do të hakmerret ndaj tyre.

Siguria e produkteve

Siguria e produkteve është qëllimi ynë më i rëndësishëm. Produktet që krijojmë shpëtojnë jetë. Secili prej nesh e ka për detyrë të përpiqet individualisht dhe në ekip dhe të punojë palodhur për të minimizuar rrezikun e lëndimeve dhe të vdekjes që vjen si pasojë e aksidenteve rrugore. Siguria e shoferëve dhe pasagjerëve është pishtari ynë udhërrëfyese në çdo gjë që bëjmë.

Siguria në vendin e punës

Ne bëjmë përpjekje të mëdha për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm pune për punonjësit tanë, kontraktorët, furnitorët dhe klientët. Ne jemi të zotuar t'i kryejmë aktivitetet tona afariste në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi për shëndetin dhe sigurinë. Secili prej nesh ka përgjegjësinë të veprojnë në mënyrë të tillë që të mbrojnë veten dhe të tjerët.

Mesazh nga udhëheqësit ekzekutivë


Suksesi ynë si lider botëror në fushën e sistemeve të sigurisë së automjeteve është rezultatet i teknologjive novatore, kontributit të një ekipi të përkushtuar, dhe zotimit të palëkundur për sinqeritet dhe integritet në çdo gjë që bëjmë. Si punonjës, ju vazhdoni të luani një rol kritik në atë që jemi sot si kompani dhe në atë që do të jemi nesër.

Në këtë kuptim, *“Kodi i etikës dhe mirësjelljes në biznes”* (“Kodi”) është një burim i rëndësishëm. Ndërsa vazhdojmë të rritemi dhe ndërkohë që peizazhi afarist vazhdon të ndryshojë, Kodi ynë na ndihmon të përmbushim çdo ditë përgjegjësitë etike dhe të pajtueshmërisë dhe të mbajmë premtimet që iu kemi bërë njeri-tjetrit, klientëve, partnerëve të biznesit dhe komuniteteve ku jetojmë dhe punojmë.

Sigurisht, Kodi ynë nuk ka si t’i përgjigjet çdo pyetjeje apo të zgjidhë çdo situatë me të cilën mund të përballeni gjatë punës. Për këtë arsye, ne ju kemi vënë në dispozicion burime të cilave mund t’iu referoheni në rastet kur paraqitet ndonjë sfidë. Nëse, në ndonjë rast, nuk jeni të sigurt për veprimin e përshtatshëm që duhet të ndërmerni apo keni ndonjë shqetësim lidhur me shkeljen e ligjit, Kodit, apo politikave ose procedurave tona, atëherë përgjegjësia juaj është të ngrini zërin.

Ju falënderojmë për përkrahjen dhe përkushtimin që keni treguar duke i realizuar veprimtaritë afariste në mënyrën e duhur. Duke punuar së bashku, duke pasur një zotim të përbashkët për respektimin e *“Parimeve udhëheqëse”*, ne do të ruajmë reputacionin që kemi fituar si kompania që i çon përpara idetë dhe teknologjinë me qëllim që të shpëtojë jetë në çdo vend të botës.

Kodi ynë



Qëllimi dhe vështrimi i përgjithshëm

Integriteti ka rëndësi.

Kur i kryeni veprimtaritë afariste në mënyrë etike, u jepni të tjerëve mesazhin se ata mund të na besojnë edhe neve, por edhe produkteve tona. Duke bërë gjënë e duhur, ju jo vetëm që mbronni reputacionin tonë, por e ndihmoni kompaninë tonë të lulëzojë në mjedisin kompleks dhe konkurrues afarist të ditëve tona.

Për të përmbushur zotimet tona, kemi hartuar këtë Kod. Kodi është i ndarë në gjashtë kapituj në të cilat paraqet standardet lidhur me:

- Sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet në fuqi, rregulloret dhe politikat e kompanisë “Joyson Safety Systems”.
- Nxitjen e integritetit dhe standardit më të lartë të sjelljes etike.
- Ndihmën që na jepni për të shmangur edhe shfaqjen e çfarëdolloj gjëje që është e papërshtatshme dhe që ka lidhje me veprimtaritë afariste të kompanisë sonë.

Kush duhet ta respektojë këtë kod

Të gjithë punonjësve, duke përfshirë punonjësit me kontratë dhe ata të përkohshëm, zyrtarët e korporatës dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve të kompanisë “Joyson Auto Holdings SA” dhe degëve e filialeve të saj të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (“Joyson Safety Systems”), iu kërkohet të lexojnë, kuptojnë dhe përmbushin standardet dhe detyrimet e paraqitura në këtë Kod. Disa partnerë të caktuar afaristë, siç janë ofruesit e shërbimeve dhe këshilltarët, shërbejnë si zgjatim i kompanisë “Joyson Safety Systems”. Prej tyre pritet të respektojnë frymën e Kodit tonë dhe çdo dispozitë kontraktuale në fuqi, gjatë kryerjes së punës për llogari të kompanisë “Joyson Safety Systems”.

Nëse mbikëqyrni partnerët tanë të biznesit apo punonjësit e përkohshëm, ju jeni përgjegjës për t’iu komunikuar standardet tona dhe për të siguruar që ata i kuptojnë këto standarde. Në rast se ndonjë partner i jashtëm i biznesit nuk i përmbush pritshmëritë tona lidhur me etikën dhe respektimin e rregulloreve e ligjeve, apo detyrimet e tyre të ndërlidhura kontraktuale, atëherë kjo mospërmbushje mund të çojë në ndërprerjen e kontratës që kemi me ta.

Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

Kompania “Joyson Safety Systems” është e zotuar t’iu përmbahet të gjitha ligjeve, rregullave dhe rregulloreve që vlejnë për biznesin tonë, në çdo vend ku zhvillojmë aktivitetet tona afariste. Është e pamundur të parashikohet çdo pyetje që mund të keni ose çdo situatë me të cilën mund të përballeni, prandaj, krahas këtij Kodi, kompania “Joyson Safety Systems” ka edhe burime të tjera prej të cilave mund të keni dobi. Këto burime shtesë janë përmendur në këtë Kod. Si gjithmonë, ne presim që ju të gjykoni drejt dhe të kërkonti ndihmë atëherë kur keni nevojë.

Ne punojmë në shumë vende, prandaj është e rëndësishme që të jemi të informuar për ligjet dhe zakonet e ndryshme të këtyre vendeve. Edhe pse i respektojmë normat e klientëve tanë, partnerëve të biznesit dhe bashkëpunëtorëve në mbarë botën, të gjithë punonjësit duhet që, të paktën, të veprojnë në pajtim me standardet dhe parimet e përcaktuara në këtë Kod. Në rast se midis Kodit tonë dhe ligjit apo një kërkesave vendore ka kundërthënie, ju duhet t’i kërkonti zyrtarit të pajtueshmërisë t’ju japë udhëzime.

Zyra e Pajtueshmërisë – Burimi juaj

Zyra e Pajtueshmërisë e kompanisë “Joyson Safety Systems” i mbikëqyr të dy: edhe Kodin, edhe programin tonë të etikës dhe pajtueshmërisë. Ky ekip ndihmon për të garantuar që kompania jonë i përmbush detyrimet e veta ligjore dhe rregullatore dhe që secili prej nesh i respekton politikën dhe procedurat në të gjithë kompaninë.

Trajnimet lidhur me këtë Kod dhe vërtetimet vjetore menaxhohen nga Zyra e Pajtueshmërisë, e cila ndihmon për të garantuar që kushdo, në çdo vend, i lexon, kupton dhe respekton Kodin tonë.

Gjithashtu, Zyra e Pajtueshmërisë është vendi ku duhet të drejtoheni nëse keni nevojë për ndihmë lidhur me ndonjë pyetje rreth këtij Kodi apo nëse keni ndonjë shqetësim. Ne besojmë se mënyra se si bëjmë biznes është po aq e rëndësishme sa edhe biznesi që bëjmë. Zyra e Pajtueshmërisë ndërmerr veprime për të promovuar respektimin e etikës në kompaninë “Joyson Safety Systems” dhe për të ruajtur e mbrojtur “Parimet tona udhëheqëse”.

Përgjegjësitë e punonjësve

Secili prej nesh duhet të marrë përgjegjësinë për të vepruar me integritet, madje edhe në rastet kur kjo nënkupton marrjen e vendimeve të vështira. Përmbushja e përgjegjësisë është ajo që na mundëson të jemi të suksesshëm dhe të rritemi.

- Veproni gjithmonë me profesionalizëm, sinqeritet dhe në mënyrë etike kurdoherë që veproni në emër të kompanisë.
- Lexojeni Kodin dhe politikën e shkruara të kompanisë dhe kushtojini vëmendje të veçantë temave që zbatohen për përgjegjësitë e punës suaj specifike.
- Kryeni të gjitha trajnimet e domosdoshme brenda afateve dhe përditësojini njohuritë për standardet dhe pritshmëritë aktuale.
- Raportoju shqetësimet për shkeljet e mundshme të ligjit, Kodit tonë apo politikave të mbikëqyrësi, udhëheqësi, apo cilido prej burimeve të renditura në këtë Kod.
- Bashkëpunoni dhe thoni të vërtetën kur i përgjigjeni një hetimi apo auditimi dhe kurrë mos ndryshoni apo shkatërroni shënime që kanë të bëjnë me një hetim apo kur pritet të realizohet ndonjë hetim.

Po Jam mbikëqyrës dhe nuk i kam të qarta detyrimet e mia nëse dikush më parashtron një akuzë. Po sikur kjo akuzë të ketë të bëjë me ndonjë udhëheqës të nivelit të lartë?
sikur...?

Pavarësisht se me çfarë ka të bëjë pretendimi, ju duhet ta raportoni patjetër. Kompania "Joyson Safety Systems" ka vënë në dispozicion disa kanale përmes të cilave mund të raportoni shqetësimet. Nëse, për çfarëdolloj arsyeje, ju nuk ndiheni rehat të parashtroni raport për një person të caktuar, mund të bisedoni me cilindo prej burimeve të tjera të përmendura në Kod ose me ndonjë anëtar tjetër të menaxhmentit.

Përgjegjësitë shtesë të mbikëqyrësve

Nga udhëheqësit e kompanisë "Joyson Safety Systems" pritet të përmbushin edhe këto përgjegjësi:

- Të jenë vetë rol model. Si mbikëqyrës që jeni, nga ju pritet të jeni vetë shembulli i ndjekjes së standardeve të larta të sjelljes etike në biznes.
- Të ndihmojnë për krijimin e një mjedisi pune ku vlerësohet respekti reciprok dhe komunikimi i hapur.
- Të jenë pikë burimi për të tjerët. Të jenë të gatshëm të komunikojnë me punonjësit, kontraktorët, furnitorët dhe partnerët e tjerë afaristë lidhur me mënyrën se si zbatohet Kodi dhe politikat e tjera në punën e tyre të përditshme.
- Të jenë proaktivë. Të kërkojnë mundësi për të diskutuar dhe adresuar me të tjerët situatat etike dhe sfiduese.
- Të reagojnë shpejt dhe në mënyrë efektive. Kur viheni në dijeni për ndonjë shqetësim, sigurohuni që shqetësimi të trajtohet me seriozitet dhe duke respektuar cilëndo palë të përfshirë.
- Të jenë të vetëdijshëm për kufizimet e autoritetit tuaj. Të mos ndërmarrin veprime që tejkalojnë autoritetin tuaj. Nëse ju ndodh ndonjëherë që të mos jeni të sigurt se çfarë është gjëja e duhur (dhe çfarë nuk është), diskutoni me mbikëqyrësin ose me zyrtarin e pajtueshmërisë.
- Të delegojnë përgjegjësi. Kurrë mos i delegoni përgjegjësi një individ për të cilin besoni se mund të sillët në mënyrë të paligjshme ose të veprojë në mënyrë joetike.

Po Kam vënë re një sjellje të keqe në një zonë që nuk e kam unë nën mbikëqyrje. A duhet ta raportoj edhe këtë problematikë?
sikur...?

Ju jeni përgjegjës kryesisht për punonjësit, kontraktorët dhe palët e tjera të treta që janë nën mbikëqyrjen tuaj, por të gjithë punonjësve të kompanisë "Joyson Safety Systems" iu kërkohet të raportojnë sjelljet e këqija. Si udhëheqës që jeni, detyra juaj kryesore është të jeni proaktivë. Qasja më e mirë është të flisni fillimisht me mbikëqyrësin që mbikëqyr zonën ku ndodh problemi, por nëse kjo është e parezaluzueshme apo joefektive, atëherë duhet të përdorni burimet e tjera të përshkruara në Kodin tonë.

Bërja e zgjidhjeve të duhura – Udhëzimet tona për vendimmarrje etike

Marrja e vendimeve të duhura nuk është gjithmonë gjë e lehtë. Në disa raste mund të ndodhë që jeni nën presion ose nuk jeni të sigurt se çfarë duhet të bëni. Mos harroni asnjëherë se çdo herë kur ju duhet të merrni një vendim të vështirë, nuk jeni asnjëherë vetëm. Juve ju janë vënë në dispozicion burime për t'ju ndihmuar.

Po përballeni me marrjen e një vendimi të vështirë?

Pyeteni veten nëse jeni të gatshëm të shihni ndonjërin prej veprimeve që mendoni të merrni, të publikuar të nesërmen, në faqen e parë të gazetës që do të lexohet nga anëtarët tuaj të familjes, shokët e shoqet dhe kolegët e koleget.

Edhe diçka...

Ne i vlerësojmë komentet tuaja. Nëse keni sugjerime lidhur me mënyrat se si mund të përmirësojmë Kodin tonë, politikat apo burimet me qëllim që të trajtojmë më mirë ndonjë problematikë specifike që keni hasur, atëherë parashtroni ato. Promovimi i sjelljes etike në kompaninë "Joyson Safety Systems" është përgjegjësi e përbashkët e të gjithëve.

Parashtrimi i pyetjeve dhe raportimi i shqetësimeve

Nëse shihni apo dyshoni për ndonjë shkelje të ligjit, Kodit tonë apo politikave të kompanisë, ose nëse keni pyetje lidhur me atë se çfarë duhet të bëni, flisni me mbikëqyrësin tuaj.

Nëse nuk ndiheni rehat të flisni me mbikëqyrësin, atëherë shfrytëzoni burimet e tjera që keni në dispozicion:

- Kontaktoni një anëtar tjetër të menaxhmentit.
- Kontaktoni me zyrtarin e pajtueshmërisë ose Burimet Njerëzore.
- Telefonojini linjës telefonike të drejtpërdrejtë për pajtueshmërinë të kompanisë "Joyson Safety Systems", ose dërgoni një mesazh në portalin në internet.


Kompania "Joyson Safety Systems" do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që shqetësimet tuaja të trajtohen në mënyrë të përshtatshme.

SHIKO ME SHUME

- Reportimi i mospajtimit
- Pa hakmarrje
- Kanali reportimit



Përpara se të vazhdoni, bëjini vetes këto pyetje:



Nëse përgjigjja ndaj të gjitha këtyre pyetjeve është "po", vendimi për të vazhduar ka të ngjarë të jetë vendimi i duhur, por nëse përgjigjja ndaj cilësdo prej këtyre pyetjeve është "jo" ose "nuk jam i sigurt", atëherë ndaloni dhe kërkoni ndihmë.

Mos harroni: Në çfarëdo situatë dhe rrethane, gjithmonë është e përshtatshme të veproni me kujdes dhe të kërkoni ndihmë.

Çfarë duhet të prisni kur përdorni linjën telefonike të drejtpërdrejtë për pajtueshmëri të kompanisë “Joyson Safety Systems”

Linja telefonike e drejtpërdrejtë dhe portali në internet janë në dispozicionin tuaj në çdo orë të ditës, gjatë gjithë javës. Telefonatës suaj do t’i përgjigjen specialistët e trajnuar të një ofruesi të tretë të pavarur të shërbimeve të pajtueshmërisë korporative; ata do të dokumentojnë shqetësimet tuaja dhe do t’i përcjellin një raport me shkrim kompanisë “Joyson Safety Systems” për hetime të mëtejshme.

Kur përdorni linjën telefonike të drejtpërdrejtë për pajtueshmëri, mund të zgjidhni të mbeteni anonimë në rastet kur këtë e lejon ligji vendor. Të gjitha raportet do të trajtohen njëlloj, pavarësisht nëse parashtrohen anonimisht apo jo.

Pasi të bëni raportimin, do t’ju dërgohet një numër identifikimi të cilin mund ta përdorni për të përcjellë procesin e trajtimit të shqetësimit tuaj. Përcjellja e procesit të trajtimit të shqetësimit tuaj është e rëndësishme sidomos nëse e keni parashtuar raportit nën anonimat, sepse ne mund të na nevojiten informata shtesë për të kryer një hetim efikas. Ky numër identifikimi do t’ju mundësojë të gjurmoni edhe zgjidhjen e rastit. Megjithatë, ju lutemi të vini re se për shkak të respektimit të privatësisë, kompania “Joyson Safety Systems” nuk do të mund t’ju informojë lidhur me veprimet disiplinore ndaj individëve.

Konfidencialiteti i çdo raporti që ju parashtrohet do të ruhet nga të gjithë individët që përfshihen në shqyrtimin e raportit dhe, nëse paraqitet nevoja, në hetimin e tij.

Mos harroni: asnjë problematikë nuk mund të zgjidhet nëse nuk i raportohet askujt.

Po Mbikëqyrësja jonë zakonisht nuk bën asgjë kur i paraqesim shqetësimet tona për ndonjë rast të mundshëm të sjelljes së keqe. Besoj se ajo ua ka **sikur...?** vështirësuar gjërat kolegëve të punës të cilët i kanë paraqitur këto shqetësime. Kam një problem: një kolegu im po bën diçka që unë besoj se është e gabuar nga pikëpamja etike. Çfarë duhet të bëj?

Merrni masat dhe ngrijeni zërin. Nga ju kërkohet që t’i raportoni rastet e sjelljes së keqe. Edhe pse shpeshherë mënyra më e mirë për t’i adresuar shqetësimet me efikasitet është të flisni së pari me mbikëqyrësen tuaj, nëse nuk mendoni se kjo është e përshtatshme apo nëse nuk ndiheni rehat po të flisni me të, atëherë duhet të bisedoni me një anëtar tjetër të menaxhmentit apo me cilindo prej burimeve të përmendura në Kod.

Po Dikush e ka keqpërdorur linjën telefonike të drejtpërdrejtë për pajtueshmëri, ka bërë telefonata anonime dhe ka akuzuar pa të drejtë **sikur...?** dikë për gabime.

Përvoja ka treguar se linja telefonike e drejtpërdrejtë për pajtueshmëri përdoret rrallë për qëllime dashakeqe, por është me rëndësi të dini se ne do të përcjellim çdo telefonatë dhe kushdo që e përdor linjën e drejtpërdrejtë në keqbesim për të përhapur gënjeshtër apo për të kërcënuar të tjerët, apo për të dëmtuar pa të drejtë reputacionin e dikujt tjetër, do t’i nënshtrohet veprimeve disiplinore deri në, dhe duke përfshirë, ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Politika jonë e moshakmarrjes

Ne nuk do të tolerojmë asnjë rast hakmarrjeje kundër ndonjë punonjësi i cili bën pyetje në mirëbesim, raporton veprimet që nuk janë në harmoni me ligjin, Kodin tonë ose politikat e kompanisë, ose që ndihmon gjatë hetimit të një shkeljeje të dyshuar.

Raportimi “në mirëbesim” nënkupton përpjekjen e sinqertë për të ofruar komente të sinqerta, të dhëna të plota e të sakta, edhe nëse më vonë del se këto komente dhe të dhëna kanë qenë të pambështetura në fakte apo të gabuara.

Po Dyshoj se në njësinë time të biznesit po ndodhin disa sjellje jo etike ku është përfshirë mbikëqyrësi im. E di që duhet t’i raportoj dyshimet që **sikur...?** kam dhe po mendoj të përdor linjën telefonike të drejtpërdrejtë për pajtueshmëri, por jam i shqetësuar se mos më hakmerren.

Detyra juaj është të raportoni sjelljen e keqe dhe, në situatën tuaj, përdorimi i linjës telefonike të drejtpërdrejtë është opsion i mirë. Ne do t’i hetojmë dyshimet tuaja dhe mund të na duhet të flasim me ju për të mbledhur më shumë informata. Pasi të bëni raportimin, nëse besoni se ndaj jush ka persona që po hakmerren, atëherë këtë duhet ta raportoni. Ne i marrim seriozisht pretendimet për hakmarrje. Raportimi i hakmarrjes do të hetohet me kujdes dhe nëse pretendimet dalin të vërteta, hakmarrësit do t’i nënshtrohen veprimeve disiplinore deri në, dhe duke përfshirë, ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Llogaridhënia dhe disiplina

Shkelja e ligjeve, Kodit tonë ose të politikave të kompanisë sonë, ose nxitja e të tjerëve për t’i shkelur ato, e ekspozon kompaninë tonë ndaj përgjegjësisë ligjore dhe e vë reputacionin tonë në rrezik. Nëse ndodh ndonjë problem që ka të bëjë me etikën apo pajtueshmërinë, juve ju kërkohet ta raportoni këtë problem me qëllim që të gjejmë një zgjidhje efektive. Gjithashtu, duhet të kuptoni se shkeljet e ligjit apo rregulloreve mund të çojnë në nisjen e procedurave ligjore dhe ndëshkime duke përfshirë, në disa rrethana, edhe ndjekjen penale.

Heqja dorë nga të drejtat dhe ndryshimet në kod


Në raste të rralla, dorëheqja e kufizuar nga të drejtat e Kodit mund të jetë e domosdoshme. Çdo kërkesë për heqje dorë nga të drejtat e këtij Kodi duhet t’i bëhet me shkrim zyrtar të parë të pajtueshmërisë.

SHIKO ME SHUME

- Reportimi i mospajtitimit
- Pa hakmarrje
- Kanali reportimit

Promovimi i një vendi

pune të sigurt dhe respektues



Diversiteti, mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi

Kompania “Joyson Safety Systems” mbledh së bashku punonjës me prejardhje, shprehi dhe kultura të ndryshme. Kombinimi i një bollëku të tillë talentesh dhe burimesh krijon ekipe të ndryshme dhe dinamike të cilat punojnë vazhdimisht drejt arritjes së rezultateve.

Kolegët tanë, aplikantët për vende të lira pune dhe partnerët e biznesit kanë të drejtë të respektohen dhe duhet të gjykohen në bazë të kualifikimeve, shprehive që kanë demonstruar dhe arritjeve të tyre.

Ne mbështetim ligjet që ndalojnë diskriminimin mbi bazën e tipareve të mbrojtura të individit si: raca, ngjyra, gjinia, kombësia, mosha, feja, aftësia e kufizuar, gjendja civile ose orientimi seksual.

Ne e respektojmë të lirinë e shoqërimit dhe u bindemi të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me orarin e punës dhe kompensimin.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Trajtojini të tjerët me respekt dhe në mënyrë profesionale.
- Nxisni diversitetin gjatë procesit të marrjes në punë të kandidatëve dhe në marrjen e vendimeve të tjera që kanë të bëjnë me punësimin.
- Mos diskriminoni të tjerët në bazë të cilësdo prej karakteristikave që mbrohen me ligj apo me politikën e kompanisë.

Bëni kujdes me

- Komentet, shakatë apo materialet, duke përfshirë postën elektronike, e cila mund të konsiderohet ofenduese.

- Njëanshmërinë e papërshtatshme gjatë gjykimin të tjerëve.

Nëse mbikëqyrni të tjerët, gjykojini në bazë të rezultateve të punës. Shmangni përfshirjen e konsideratave të pa ndërlidhura në vendimet tuaja. Përdorni standarde objektive dhe të kuantifikueshme.

Po sikur...?

Një prej kolegëve dërgon postë elektronike me shaka dhe komente tallëse për kombësi të caktuara. Këto më bëjnë të mos ndihem rehat, por askush nuk e ka ngritur zërin për këto komente. Çfarë duhet të bëj?

Duhet të njoftoni mbikëqyrësin tuaj të drejtpërdrejtë ose Burimet Njerëzore.

Dërgimi i këtyre shakave shkel vlerat dhe politikat tona që kanë të bëjnë me përdorimin e postës elektronike dhe standardet tona për diversitetin, ngacmimin dhe diskriminimin. Duke mos bërë asgjë, ju nuk i vini fre diskriminimit dhe toleroni besimet që mund të rrënojnë seriozisht atmosferën e ekipeve, atmosferë kjo që të gjithë ne kemi punuar ta krijojmë.

Një vend pune ku nuk ka ngacmime

Ne kemi të drejtë të punojmë në një mjedis ku nuk ka kërcënim, ngacmim dhe abuzim.

Sjellja verbale ose fizike e cilitdo punonjës që ngacmon të tjerët, pengon të tjerët në arritjen e rezultateve të tyre të punës, apo krijon një mjedis pune kërcënues, ofendues, abuzive apo armiqësor, nuk do të tolerohet.

Në kompaninë “Joyson Safety Systems” ne nuk tolerojmë:

- Komentet kërcënuese, telefonatat e pahijshme, ndjekjen fshehurazi të të tjerëve ose çfarëdolloj forme tjetër ngacmimi.
- Shkaktimin e lëndimeve fizike tek të tjerët.
- Dëmtimin e qëllimshëm të pronës së dikujt tjetër ose veprimet agresive që bëjnë që dikush tjetër të ketë frikë se mos pëson lëndime.
- Kërcënimet, frikësimin apo detyrimin e të tjerëve për të hyrë apo dalë nga ambientet e punës – në asnjë kohë, për asnjë qëllim.
- Armët dhe materialet e rrezikshme që nuk lejohen në vendin e punës, ku nuk përfshihet vetëm ambientet tona, por edhe parkingu dhe vendndodhjet alternative që mirëmbahen nga kompania.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Ndhimoheni njeri-tjetrin duke ngritur zërin në rastet kur sjellja e një kolegu i bën të tjerët të mos ndihen rehat.
- Mos toleroni kurrë ngacmimin seksual, ku përfshihet kërkesa për favore seksuale apo sjelljet e tjera të papëlqyera verbale ose fizike të natyrës seksuale.
- Demonstroni profesionalizëm. Mos vizitoni faqe të papërshtatshme interneti ose mos shfaqni fotografi të turpshme ose ofenduese.

- Nxisni një qëndrim pozitiv ndaj politikave që janë projektuar për të krijuar një vend pune të sigurt, etik dhe profesional.
- Raportojini të gjitha incidentet e ngacmimit dhe frikësimit, të cilat mund të kompromentojnë aftësinë tonë për të punuar së bashku dhe për të qenë produktivë.

Bëni kujdes me

- Komentet, gjestet apo kontaktet fizike të papëlqyera.
- Shfaqjen e fotografive me përmbajtje të turpshme seksuale apo materialeve të tjera.
- Barsoletat ose komentet seksuale ose ofenduese (të shprehura qartë apo të nënkuptuara) dhe vështrimet epsharake.
- Abuzimin verbal, kërcënimet apo përbuzjen.

Ngacmimi seksual

Një prej formave të zakonshme të ngacmimit është ngacmimi seksual, i cili, në përgjithësi, ndodhur kur:

- Veprime të papëlqyera bëhen kusht për t'u marrë në punë ose përdoren si bazë për marrjen e vendimit për punësimin, si p.sh. Kërkesa për të dalë në takime, kërkesa për favore seksuale apo sjellje të tjera të ngjashme të natyrës seksuale.
- Si pasojë e përparimeve seksuale të padëshiruara, barsoletave fyese apo sjelljeve të tjera ofenduese verbale ose fizike të natyrës seksuale, krijohet një ambient pune kërcënues, fyese ose armiqësor.

Po sikur...? Gjatë një udhëtimi për punë, një koleg imi kë ka kërkuar vazhdimisht të dalim për të pirë diçka bashkë dhe ka komentuar për pamjen time, gjë që më ka bërë të ndihem jo rehat. I kam kërkuar të mos e bëjë më këtë, por ai nuk ndalonte. Ne nuk ishim në zyrë dhe kjo situatë ndodhi pas orarit të rregullt të punës, kështu që nuk isha e sigurt se çfarë duhej të bëja. A është ngacmim ky?

Po, ngacmim është. Kjo lloj sjelljeje nuk tolerohet, jo vetëm gjatë orarit të punës, por as në situatat që kanë të bëjnë me punën, ku përfshihen edhe udhëtimet afariste. Thuajini kolegut që këto veprime janë të papërshtatshme dhe që ai duhet të mos vazhdojë kështu. Në rast se vazhdon, raportojeni problemin.

Po sikur...? Sapo mora vesh që një shoku im i mirë është akuzuar për ngacmim seksual dhe se për këtë ka nisur një hetim. Nuk e besoj të jetë e vërtetë kjo dhe mendoj se është e drejtë që shokut tim t'i jap një paralajmërim të hershëm me qëllim që ai të mbrojë veten. A nuk kam unë përgjegjëse, si shok që e kam, që ta paralajmëroj?

Atë nuk duhet ta paralajmëroni në asnjë rrethanë. Shokut tuaj do t'i jepet mundësia t'i përgjigjet këtyre akuzave. Ne do të bëjmë çdo përpjekje për të kryer një hetim të drejtë e të paanshëm. Pretendimet për ngacmim seksual janë çështje shumë serioze, që kanë pasoja jo vetëm për individët e përfshirë, por edhe për kompaninë tonë. Duke paralajmëruar shokun tuaj, ju mund të vini në rrezik hetimin dhe ta ekspozoni kompaninë tonë ndaj rreziqeve të tjera dhe kostove të mundshme.

Mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm

Garantimi i sigurisë është pjesë përbërëse e çdo gjëje që bëjmë gjatë procesit të prodhimit dhe operacioneve si dhe gjatë veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit. Secili prej nesh ka përgjegjësinë të veprojnë në mënyrë të tillë që të mbrojnë veten dhe të tjerët.

Ne mund t'i arrijmë qëllimet tona për krijimin e një vendi pune të sigurt dhe të shëndetshëm vetëm përmes pjesëmarrjes aktive dhe përkrahjes të gjithsecilit. Situatat që paraqesin rrezik për shëndetin, sigurinë ose mjedisin duhet të raportohen menjëherë. Të gjitha raportimet mund të kryhen pa pasur frikë nga hakmarrja.

Siguria është kusht për punësimin. Ne presim që secili drejtor, zyrtar dhe punonjës të zotohet për ta bërë kompaninë "Joyson Safety Systems" një vend pune ku nuk ndodhin aksidente.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Respektoni rregullat dhe praktikrat që zbatohen në punën tuaj lidhur me mbrojtjen, sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.
- Njoftojeni menjëherë mbikëqyrësin tuaj për çdo pajisje të pasigurt apo çdo situatë që mund të paraqesë rrezik për shëndetin ose sigurinë apo të dëmtojë mjedisin. Si punonjës që jeni, ju keni të drejtën dhe detyrimin të ndërprisni çfarëdolloj pune nëse mendoni se siguria juaj është në rrezik.
- Mirëmbani një mjedis të rregullt dhe të sigurt pune duke larguar vazhdimisht sendet penguese, telat dhe rreziqet e tjera të mundshme. nga repartet e punës, korridoret dhe ambientet e tjera ku punohet.

Bëni kujdes me

- Praktikrat ose kushtet e pasigurta për punë.
- Pakujdesinë gjatë zbatimit të standardeve të sigurisë, siç janë procedurat e hyrjes në impiant dhe protokollet për fjalëkalimet.

Alkooli dhe drogat

- Gjatë punës ose gjatë operacioneve afariste, nuk duhet t’i dobësoni kurrë aftësitë dhe gjithmonë duhet të jeni të gatshëm të kryeni detyrat e punës.
- Gjatë realizimit të operacioneve afariste të kompanisë, mos përdorni, mos posedoni dhe mos jeni nën ndikimin e drogave të paligjshme apo ndonjë substance që do të mund të ndikonte në cenimin e mjedisit të sigurt dhe efikas të punës ose që do të dëmtonte reputacionin e kompanisë.

Dhuna në vendin e punës

Asnjë formë e dhunës nuk ka vend në kompaninë “Joyson Safety Systems”. Ne nuk tolerojmë:

- Sjelljet frikësuese, kërcënuese ose armiqësore.
- Shkaktimin e lëndimeve fizike tek të tjerët.
- Aktet e vandalizmit, zjarrvënien e qëllimshme, sabotazhin ose aktivitetet e tjera kriminale.
- Mbajtjen e armëve dhe materialeve të rrezikshme në pronën e kompanisë, përveç nëse jeni të autorizuar t’i mbani.
- Posedimin e armëve të zjarrit, eksplozivit ose armëve të tjera të rrezikshme në ambientet e kompanisë “Joyson Safety Systems” ose përdorimin e një sendi si armë.
- Shkaktimin e lëndimeve ose dëmtimeve ose kërcënimit për shkaktim lëndimesh ose dëmtimesh ndaj jetës, shëndetit, mirëqenies, familjes ose pronës së një personi tjetër.

Po sikur...? Kam vënë re disa praktika në zonën time, të cilat nuk më duken të sigurta. Me kë mund të flas? Unë sapo kam filluar të punoj këtu dhe nuk dua të më konsiderojnë si person që sjell telashe.



Diskutojini shqetësimet tuaja me mbikëqyrësin tuaj ose me Burimet Njerëzore. Ata mund të kenë arsye shumë të vlefshme për ndjekjen e këtyre praktikave, por është e rëndësishme të mos harroni se ngritja e shqetësimeve lidhur me sigurinë nuk ju bën person që shkaktoni telashe, por punonjës të përgjegjshëm dhe që shqetësohet për sigurinë e të tjerëve.

Po sikur...? Një nënkontraktor shkel standardet tona. A pritet prej kontraktorëve të ndjekin të njëjtat politika dhe procedura për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë sikurse punëdhënësit?

Absolutisht! Mbikëqyrësit janë përgjegjës për të garantuar që nënkontraktorët dhe ofruesit e shërbimeve që punojnë në ambientet e kompanisë “Joyson Safety Systems” të kuptojnë dhe të respektojnë të gjitha ligjet në fuqi dhe rregulloret që udhëheqin impiantin në fjalë, si dhe kërkesat e tjera që mund të imponojë kompania jonë.

Puna me klientët dhe

partnerët tanë afaristë



Marrëveshjet e ndershme dhe të drejta

Ne i trajtojmë klientët dhe partnerët tanë të biznesit në mënyrë të drejtë. Ne punojmë për të kuptuar dhe plotësuar nevojat e tyre, duke i qëndruar njëkohësisht besnikë standardeve etike që kemi vendosur vetë. Ne themi të vërtetën për shërbimet dhe mundësitë tona dhe kurrë nuk bëjmë premtime që nuk mund t'i mbajmë.

Shkurt e shqip, ne i trajtojmë klientët dhe partnerët tanë të biznesit ashtu siç do të donim të na trajtonin ata ne.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Trajtojeni secilin klient me drejtësi dhe ndershmëri.
- Thuajeni mendimin dhe flisni me mbikëqyrësin tuaj menjëherë në rast se jeni të shqetësuar për ndonjë gabim, lëshim, vonesë të panevojshme, apo defekt në cilësinë ose shërbimin tonë ndaj klientit.
- Sillni menjëherë në vëmendjen e mbikëqyrësit çdo konflikt të mundshëm interesi midis jush, klientëve tanë ose kompanisë tonë.
- Kurrë mos zbatoni kërkesat e klientëve për të bërë diçka që ju e shihni si jo etike ose të paligjshme, duke përfshirë këtu edhe modifikimin e të dhënave apo raporteve të testimit.
- Jini të përgjegjshëm në raport me kërkesat dhe pyetjet e klientëve. Premtoni vetëm gjëra që mund t'i realizoni dhe mbajeni fjalën.

Bëni kujdes me

- Presionin nga kolegët apo mbikëqyrësit për të qenë të pakujdesshëm lidhur me cilësinë ose standardet e realizimit të punëve.
- Tundimin për t'u thënë klientëve atë që mendoni ju se duan të dëgjojnë dhe jo të vërtetën. Nëse ndodheni përballë një situatë të paqartë, filloni duke paraqitur një panoramë të drejtë e të përpiktë e cila do të shërbejë si bazë për të marrë një vendim.

Marrëdhëniet me furnitorët

Kompania “Joyson Safety Systems” i vlerëson dhe bashkëpunon me furnitorë të kualifikuar (duke përfshirë këtu ofruesit e shërbimeve) Gjatë përzgjedhjes së furnitorëve, ne vlerësojmë aftësinë e secilit furnitor në drejtim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave tona afariste dhe teknike. Gjithashtu, vendimet për blerje i marrim duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet afatgjata të kompanisë “Joyson Safety Systems”. Të gjitha marrëveshjet negocohen në mirëbesim dhe duhet të jenë të drejta e të arsyeshme për të dyja palët.

Mbrojtja e të dhënave konfidenciale të palëve të tjera

Klientët tanë, partnerët e biznesit dhe palët e tjera na japin besimin e tyre. Ne duhet t’i mbrojmë patjetër informatat konfidenciale.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Kuptoni pritshmëritë e klientëve dhe partnerëve të biznesit lidhur me mbrojtjen, përdorimin dhe shpалosjen e informatave konfidenciale që ata na japin.
- Kufizoni çdo qasje në informatat konfidenciale të palëve të treta vetëm tek ata persona që duhet patjetër t’i përdorin këto informata për të kryer punën e tyre dhe vetëm për qëllime për të cilat kanë autorizim.
- Mos kërkonte dhe mos pranoni sekrete tregtare ose informata konfidenciale të konkurrentëve përveç nëse shpалosja mbulohet me marrëveshje për mosshpалosje të informatave ose marrëveshje konfidencialiteti, të miratuar nga Departamenti Ligjor ose ai i Pajtueshmërisë.
- Raportojeni menjëherë te mbikëqyrësit tuaj çdo humbje ose vjedhje të informatave konfidenciale.

SHIKO ME SHUME

- Politika për konkurrencë të drejtë

Bëni kujdes me

- Kërkesat nga ana e partnerëve të biznesit për informata konfidenciale lidhur me klientët tanë ose partnerët e tjerë të biznesit, në rast se nuk kanë kërkesë ose autorizim të ndërlidhur afarist.

- Ekspozimin e paqëllimtë të informatave konfidenciale lidhur me klientët tanë ose partnerët e biznesit në ambientet publike ose në rrjete të pasigurta.

Ruajtja e integritetit të të dhënave tona

Klientët tanë dhe shoferët na besojnë mbrojtjen e jetës së tyre. Ne jemi përgjegjës për të garantuar që produktet tona të projektohen, prodhohen, testohen dhe të bëhen të përshtatshme për përdorim, mbështetur në të dhëna të sakta, të besueshme dhe të plota. Cilësia e produkteve është prioriteti ynë parësor. Pacenueshmëria e të dhënave është një prej aspekteve themelore të sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanisë sonë.

Kompania “Joyson Safety Systems”, dhe jo punonjësit ose departamentet, është pronar i të dhënave, por secili prej nesh është përgjegjës për të garantuar që të dhënat të krijojnë dhe përftoheshin, regjistrohen, raportohen, ruhen dhe sistemohen në pajtim me politikën dhe procedurat e kompanisë dhe ligjet në fuqi.

Presim nga të gjithë të punësuarit ta mirembajnë politiken e kompanisë, procedurat dhe ligjet.

Secili nga ne duhet të përmbahet çdo princip për integritetin e të dhënave, me qëllim që të sigurohemi se të dhënat tona janë të pastra, të azhuruara, origjinale dhe të sakta.

Ne patjetër duhet të përmbahemi nga çfarëdo lloj pune e cila mund ta cojë në pyetje integritetin e të dhënave tona, duke futur falsifikimin e të dhënave, ndryshime të paautorizuara, humbjen e të dhënave, fshirjen e të dhënave, ose kopjimit e të dhënave. Edhe ne duhet patjetër të raportojmë çfarëdo lloj problemi që ka lidhje me integritetin e të dhënave tona (p.sh. gabime, leshime ose manipulime ndërkombëtare me të dhënat).

Nëse jeni përgjegjës për hedhjen e të dhënave ose verifikimin e saktësisë së të dhënave, respektoni politikën dhe procedurat e krijuara dhe udhëzimet e punës. Nëse jeni mbikëqyrës ose menaxher përgjegjës për cilësinë dhe integritetin e të dhënave në departamentin ku punoni, sigurohuni që çdo qasje në të dhëna të jetë e autorizuar, që të ndiqen procedurat dhe që regjistrat me të dhëna të përditësohen dhe mirëmbahen në mënyrë të tillë që të jenë të auditueshme.



Ndiqui parimet tona udhëheqëse

- Sigurohuni që të dhënat të jenë të sakta dhe të vërteta dhe të pasqyrojnë atë që ka ngjarë në të përshkruara, të pastra, të azhuruara, origjinale dhe të sakta.
- Kurrë mos u përfshini në asnjë sjellje që vë në pikëpyetje integritetin e të dhënave, duke përfshirë falsifikimin e të dhënave, bërjen e ndryshimeve të paautorizuara ose ndërrimin e të dhënave ose shkatërrimin, fshirjen apo mbishkrimin e këtyre të fundit.
- Raportoni çdo problematikë që ndikon në integritetin e të dhënave tona (p.sh. gabimet, leshimet ose manipulimin e qëllimtë të të dhënave).

Po sikur...? Besoj se një prej dizajneve të reja që kemi futur në përdorim mund të krijojë rrezik për sigurinë. Shqetësimet e mia ia kam raportuar mbikëqyrëses. Edhe ajo ka të njëjtin shqetësim si unë, por nuk po merr asnjë veprim sepse ne tashmë e kemi prodhuar produktin dhe sipas saj rreziku i lëndimit është i vogël. Çfarë duhet të bëj?

Mos fshihni asgjë që besoni se mund të paraqesë rrezik të arsyeshëm ndaj cilësisë, shërbimeve, reputacionit ose interesave tona. Informoni për këtë çështje një anëtar tjetër të menaxhmentit ose zyrtarin e pajtueshmërisë.

Po sikur...? Kam arsye të besoj se një bashkëpunëtor mund të ketë bërë disa ndryshime të paautorizuara në disa raporte testimi. Çfarë duhet të bëj?

Duhet t'i raportoni menjëherë dyshimet tuaja duke përdorur cilindo prej mekanizmave të raportimit, të përmendur në Kodin tonë. Mos harroni detyrimin që kemi për të ruajtur besimin e klientëve tanë dhe integritetin e të dhënave. Ngrijeni zërin nëse shihni ose dyshoni për falsifikim të dhënash, ndryshime të paautorizuara të dhënash, shkatërrim të dhënash ose çdo sjellje tjetër që mund të vërë në pikëpyetje saktësinë e të dhënave tona.

SHIKO ME SHUME

- Politika e integritetit e të dhënave.

Konflikti i interesit

Konflikti i interesit mund të ndodhë atëherë kur keni një interes konkurrues, i cili mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të marrë vendime objektive në interes të kompanisë “Joyson Safety Systems”. Nga secili prej nesh pritet të përdorë gjykim të arsyeshëm dhe të shmangë situatat që mund të çojnë madje edhe në shfaqjen e konfliktit, gjë që mund të minojë besimin që na japin të tjerët dhe të dëmtojë reputacionin tonë.

Konflikti i interesit mund të jetë real, potencial, ose thjesht çështje perceptimi. Meqenëse këto situata nuk janë gjithmonë të qarta, duhet që t’ia shpalosni ato plotësisht mbikëqyrësit tuaj me qëllim që ne kemi mundësi t’i vlerësojmë, monitorojmë dhe menaxhojmë ato në mënyrën e duhur.

SHIKO ME SHUME

- Politika e konfliktit të interesit.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Shmangini situatat e konfliktit të interesit kurdoherë që është e mundur.
- Gjithmonë merrni vendime afariste në interesin më të mirë të kompanisë “Joyson Safety Systems”.
- Diskutojini me mbikëqyrësit të gjitha hollësitë e çdo shtate që mund të perceptohet si konflikt i mundshëm interesit.
- Mendoni paraprakisht dhe adresojini në mënyrë proaktive situatat që mund t’i vënë interesat tuaja apo ato të ndonjë anëtari të familjes suaj në konfliktin të mundshëm me ato të kompanisë “Joyson Safety Systems”.

Jini syçelë ndaj situatave të tilla si ato që paraqiten më poshtë dhe që janë shembuj të zakonshëm të konflikteve të mundshme të interesit:

Mundësitë e ofruara nga korporatat

Nëse informoheni për ndonjë mundësi biznesi në kuadrin e punës suaj, atëherë kjo mundësi i takon në fillim kompanisë “Joyson Safety Systems”. Kjo do të thotë se ju nuk duhet të përfitonit nga kjo mundësi për veten tuaj, përveç nëse merrni miratimin nga zyrtari i pajtueshmërisë.

Shokët dhe të afërmit

Ndonjëherë ndodh që mund të gjendeni në një situatë ku punoni me një shok të ngushtë ose të afërm që punon për një klient, furnitor ose konkurrent. Meqenëse është e pamundur të parashikohen të gjitha situatat e mundshme që mund të krijojnë një konflikt potencial, ju duhet t’ia tregoni mbikëqyrësit tuaj situatën ku ndodheni me qëllim që të përcaktohet nëse duhet të merret ndonjë masë paraprake.

Punësimi i jashtëm

Për të siguruar mospasjen e konflikteve dhe adresimin e problematikave të mundshme, ju duhet ta informoni çdo herë mbikëqyrësin lidhur me punësimin e jashtëm dhe të diskutoni me të lidhur me këtë punësim. Në rast se ju jepet miratimi, ju duhet të garantoni që aktiviteti jashtë marrëdhënies së punës nuk do të ndërhyjë në punën tuaj në kompaninë “Joyson Safety Systems”. Puna për një konkurrent, furnitor ose klient mund të shkaktojë konflikte që duhet të zgjidhen. Gjithashtu, çdo aktivitet afarist komplementar ose personal, që miratohet, nuk duhet të konkurrojë me kompaninë “Joyson Safety Systems”.

Investimet personale

Konflikti mund të ndodhë nëse keni pronësi të konsiderueshme ose interesa të tjera financiare në një konkurrent, ofrues shërbimi, furnitor ose klient. Sigurohuni që të dini se çfarë ju lejohet dhe çfarë nuk ju lejohet sipas politikave tona dhe kërkonti ndihmë për çdo pyetje që mund të keni.

Aktivitetet e angazhimit qytetar

Përveç rasteve kur menaxhmenti i kompanisë ju kërkon specifikisht të veproni kështu, ju nuk duhet të pranoni të merrni pjesë në takimin e bordit të drejtorëve ose bordit këshillues të asnjërit prej konkurrentëve, furnitorëve, klientëve ose partnerëve tanë, sidomos nëse vendi i punës që keni aktualisht ju jep mundësi të ndikoni në marrëdhënien tonë me ta.

Dhuratat dhe zbavitja

Një dhuratë modeste mund të jetë një shenjë falënderimi e menduar mirë, ose një drekë ose darkë mund të jetë vendi i duhur për të zhvilluar ndonjë diskutim afarist. Megjithatë, nëse nuk menaxhohet si duhet, shkëmbimi i dhuratave dhe pjesëmarrja në aktivitete zbavitëse mund të duket se krijojnë një konflikt interesi ose sjellje tjetër të gabuar. Kjo është e vërtetë sidomos në rastet kur ndodh shpesh ose nëse vlera është aq e madhe sa që mund të mendohet se mund të ketë ndikim jo të mirë në vendimmarrjen afariste. Gjithashtu, duhet të krijohen dhe mirëmbahen regjistra të saktë të këtyre shpenzimeve.

SHIKO ME SHUME

- Politika kundër korupcionit.
- Politika për dhuratat dhe manifestimet.

Ne nuk pranojmë dhe nuk japim ose ofrojmë dhurata, favore apo ftesa për të marrë pjesë në veprimtari zbavitëse, edhe nëse këto janë në pajtim me politikat tona, në rast se qëllimi është të ndikohet negativisht në ndonjë vendim. Ju lutemi t'i referoheni pjesës "Lufta ndaj korrupsionit dhe ryshfetit" << hiperbolik >> të Kodit, për të mësuar më shumë lidhur me gjërat që konsiderohen të përshtatshme dhe jo të përshtatshme.

Gjithashtu, mbani parasysh që rregullat që kanë të bëjnë me gjërat që mund t'u japim apo të pranojmë prej zyrtarëve qeveritarë, të afërmve të tyre ose personave juridikë të ndërlidhur janë shumë më të rrepta. Mos u ofroni asgjë të vlefshme këtyre individëve pa marrë miratimin paraprak të zyrtarit të pajtueshmërisë.



Ndiqui parimet tona udhëheqëse

- Mos bëni dhurata dhe mos organizoni/ftoni në veprimtari zbavitëse dhe mos i jepni asgjë të çmuar asnjë zyrtari qeveritar pa marrë miratimin paraprak të zyrtarit të pajtueshmërisë.
- Jepni dhe pranoni vetëm dhurata dhe merrni pjesë vetëm në aktivitete zbavitëse të cilat plotësojnë me arsye marrëdhëniet afariste.
- Kurrë mos pranoni dhurata të asnjë lloji prej një partneri afarist me të cilin jeni të përfshirë në kuadrin e negociatave për lidhjen e një kontrate.
- Shkëmbeni dhurata dhe shkoni në veprimtari argëtuese të cilat ushqejnë vullnetin e mirë në marrëdhëniet afariste, por kurrë mos ofroni dhe mos

pranoni dhurata ose ftesa për të marrë pjesë në veprimtari argëtuese të cilat e bëjnë pranuesin të ndihet ose të duket sikur është i detyruar të bëjë diçka të caktuar.

- Mos kërkonti dhe mos pranoni dhurata personale, favore, ftesa për të marrë pjesë në veprimtari argëtuese apo shërbime.
- Kurrë mos pranoni para të gatshme (kesh) ose barasvlerës të tyre.
- Kuptojini dhe respektojini politikat e organizatës së pranuesit (marrësit) përpara se t'i ofroni ose jepni dhurata, favore apo ftesa për të marrë pjesë në veprimtari argëtuese.
- Ngrijini shqetësimet çdo herë që dyshoni se ndonjë koleg, palë e tretë ose agjent tjetër i kompanisë ka të ngjarë të jetë përfshirë në ndonjë përpjekje për të ndikuar, në mënyrë të parregullt, në vendimmarrjen e një klienti ose zyrtari qeveritar.

Bëni kujdes me

- Situatat që mund t'ju vënë në siklet ju ose kompaninë tonë, duke përfshirë pjesëmarrjen në aktivitete zbavitëse me natyrë seksuale.
- Dhuratat, favorët ose ftesat për aktivitete zbavitëse, të cilat mund të jenë të arsyeshme për një klient privat, por jo për një zyrtar ose agjenci qeveritare.

Po sikur...?

Gjatë një udhëtimiti, një partner biznesi më dha një dhuratë që mendoj se ishte e tepërt. Çfarë duhet të bëj?

Duhet të vini në dijeni mbikëqyrësin dhe zyrtarin e pajtueshmërisë sa më shpejt që keni mundësi. Ndoshta do të na duhet ta kthejmë dhuratën duke e shoqëruar me një letër ku shpjegohet politika që ndjekim. Nëse dhurata është e përkohshme ose nëse nuk është praktike të kthehet, një tjetër mundësi mund të jetë që atë t'ua japim punonjësve ose ta japim për bamirësi, duke i dërguar dhuruesit një letër me shpjegime.

Po sikur...?

Gjatë negociatave për lidhjen e një kontrate me një furnitor të ri të mundshëm, furnitori i ri tha se ishte regjistruar në një seminar për bizneset lokale. Ai nuk kishte mundësi të shkonte dhe më pyeti nëse kisha dëshirë të shkoja unë në vend të tij. Në fakt, prej kohësh kisha menduar të merrja pjesë në seminar, meqenëse tema e seminarit është e vlefshme për punën time. Unë për vete nuk kam asnjë përfitim personal. Pjesëmarrja do të ishte gjë e mirë për kompaninë "Joyson Safety Systems" dhe do të ishte për të ardhur keq që regjistrimi të shkonte dëm. Kisha në plan t'i thosha "po", por tani pyes veten nëse ky do të ishte vendimi i duhur.


Ju duhet ta refuzoni ofertën. Nëse jeni të përfshirë në negociatë për lidhje kontrate, ju nuk duhet të pranoni kurrë asnjë dhuratë gjatë procesit të negociatave. Pranimi i dhuratave gjatë procesit të negociatave mund të lërë përshtypjen e diçkaje të gabuar dhe është gjithmonë i pavend.

SHIKO ME SHUME

- Politika kunder korupcionit.
- Politika për dhuratat dhe manifestimet.

Ruajtja e të

dhënave dhe asetëve



Ruajtja e asetëve të kompanisë sonë

Neve na janë besuar asetet e kompanisë dhe mbajmë përgjegjësi personale për t'i mbrojtur ato dhe për t'i përdorur me kujdes. Në asetet e kompanisë bëjnë pjesë: fondet, ambientet, pajisjet, sistemet informative, pronësia intelektuale dhe informatat konfidenciale.

Shkurajohet përdorimi i asetëve të kompanisë për qëllime personale, por në rastet kur lejohet, ato duhet të përdoren sa më pak dhe të mos kenë ndikim negativ në produktivitet dhe mjedisin e punës.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Mos i përdorni pajisjet ose sistemet informative të kompanisë "Joyson Safety Systems" për të krijuar, ruajtur ose dërguar përmbajtje të cilën të tjerëve mund t'iu duket ofenduese.
- Mos ia tregoni askujt fjalëkalimin dhe mos i lejoni të tjerët, duke përfshirë këtu shokët dhe pjesëtarët e familjes, të përdorin burimet e kompanisë "Joyson Safety Systems".
- Përdorni vetëm softuerët që janë licencuar si duhet. Ndalohet rreptësisht kopjimi ose përdorimi i softuerëve të palicencuar ose "të piratuar" në kompjuterët e kompanisë ose pajisjeve të tjera për të kryer aktivitetet afariste të kompanisë. Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me atë nëse ndonjë softuer i caktuar është i licencuar për përdorim, kontaktoni me Departamentin e TI-së.

Bëni kujdes me

- Kërkesat për të marrë hua ose përdorur pajisjet e kompanisë "Joyson Safety Systems" pa miratim.
- Individët e panjohur, që nuk kanë kredencialet e duhura për të hyrë në ndërtesën tonë.
- Përdorimin e tepërt të burimeve të kompanisë "Joyson Safety Systems" për qëllime personale.

Të dhënat konfidenciale dhe pronësia intelektuale

Kompania “Joyson Safety Systems” zoton burime të konsiderueshme për zhvillimin teknologjik dhe inovacionin. Krijimi dhe mbrojtja e të drejtave të pronësisë sonë intelektuale janë vendimtare për biznesin tonë. Pronë intelektuale janë artikuj të tillë si: të dhënat pronësore, sekretet tregtare dhe patentat.

Secili prej nesh duhet të jetë syçelë dhe të mbrojë informatat konfidenciale dhe pronën intelektuale të kompanisë “Joyson Safety Systems”. Kjo nënkupton sigurimin dhe kufizimin e qasjes tek ata persona që duhet patjetër t’i dinë këto informata për të kryer punën e tyre dhe për t’i përdorur ato vetëm për qëllimet për të cilat kanë autorizim.

Mbani parasysh që detyrimi për të kufizuar përdorimin nga ana juaj të informatave konfidenciale dhe pronës intelektuale të kompanisë “Joyson Safety Systems” vazhdon edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Përdorini dhe shpalosini informatat konfidenciale vetëm për qëllime të ligjshme të biznesit.
- Etiketojini në mënyrën e duhur informatat konfidenciale me qëllim që të tregohet se si duhet të menaxhohen, shpërndahen dhe shkatërrohen.
- Mbrojeni pronën intelektuale dhe informatat konfidenciale duke i bashkëndarë ato vetëm me palë të interesuara.
- Ruajini ose komunikojini informatat e kompanisë vetëm duke përdorur sistemet informative të kompanisë “Joyson Safety Systems”.

Bëni kujdes me

- Diskutimin e informatave konfidenciale të kompanisë “Joyson Safety Systems” në vende ku mund t’ju përgjojnë, për shembull në aeroplan, ashensorë ose kur përdorni telefonat celularë.
- Dërgimin e informatave konfidenciale te makinat e faksit ose printerët e pambikëqyrrur.

Prona intelektuale

Prona intelektuale është një aset i rëndësishëm që duhet të mbrohet patjetër. Shembuj të pronës intelektuale janë:

- Planet e biznesit dhe planet e marketingut;
- Nismat (ekzistuese, të planifikuara, të propozuara ose në zhvillim e sipër) të kompanisë;
- Listat e klientëve;
- Sekretet tregtare dhe zbulimet;
- Metodrat, njohuritë praktike dhe teknikat;
- Inovacionet dhe projektimet;
- Sistemet, softuerët dhe teknologjia;
- Patentat, markat tregtare dhe të drejtat e autorit;

Kontaktoni me Departamentin Ligjor nëse merrni ndonjë deklaratë apo pyetje nga palë të treta lidhur me; (1) fushëveprimin e të drejtave të pronës intelektuale të kompanisë “Joyson Safety Systems”; (2) zbatueshmërinë e të drejtave të kompanisë “Joyson Safety Systems” në produktet e kompanive të tjera; ose (3) zbatueshmërinë e të drejtave të pronës intelektuale të një pale të tretë në të drejtat e pronës intelektuale ose produktet e kompanisë “Joyson Safety Systems”.

Informojeni menjëherë menaxhmetin e kompanisë për çdo shpikje ose pronë intelektuale tjetër që ju krijoni gjatë kohës kur jeni të punësuar nga kompania “Joyson Safety Systems”.

Përftimi i inteligjencës konkurruese

Informacionet për konkurrentët janë aset i vlefshëm në mjedisin e biznesit konkurrues të ditëve tona. Gjatë grumbullimit të inteligjencës afariste, punonjësit e kompanisë “Joyson Safety Systems” dhe personat e tjerë që punojnë për interesin tonë, duhet të ndjekin patjetër standardet më të larta etike.

Ndalohet në çdo kohë shkëmbimi i informacioneve me konkurrentin ose punonjësit e një konkurenti. Ne nuk duhet të angazhohemi kurrë në mashtrime, deklarata të rreme ose sjellje dinakërore për qëllime të përfimit të informacioneve. As nuk duhet të përdorim teknologji invazive për të “spiunuar” të tjerët. Gjithashtu, duhet të jemi të kujdesshëm kur pranojmë informata nga palët e treta. Ju duhet t’i njihni dhe t’iu besoni burimeve të tyre dhe të siguroheni që informatat që ato japin nuk mbrohen me ligjet për sekretet tregtare ose marrëveshjet për mosshpalosje të informatave ose marrëveshjet e konfidencialitetit.

Edhe pse kompania “Joyson Safety Systems” punëson edhe ish-punonjës të konkurrentëve, ne i njohim dhe i respektojmë detyrimet e këtyre punonjësve për të mos përdorur ose shpalosur informata konfidenciale të ish-punëdhënësve të tyre.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- iguroni informacione konkurruese vetëm përmes rrugëve ligjore dhe etike, dhe kurrë përmes deklaratave të rreme.
- Respektoni detyrimet që kanë të tjerët për të ruajtur konfidencialitetin e informatave konkurruese.

Bëni kujdes me

- Mbajtjen e letrave ose regjistrimeve kompjuterike të punëdhënësve të mëparshëm në kundërshtim të ligjeve ose kontratave.
- Përdorimin e informatave konfidenciale të dikujt pa miratimin e duhur.
- Përdorimin e intervistave të punës si mënyrë për të mbledhur informata konfidenciale lidhur me konkurrentët apo palët e tjera.
- Pranimin e sugjerimeve nga palë të treta lidhur me produktet e reja, karakteristikat e produkteve ose shërbimet atëherë kur nuk dihet plotësisht burimi i idesë origjinale.

Krijimi dhe menaxhimi i të dhënave të biznesit tonë

Saktësia dhe plotësia e shpalosjes së informatave dhe shënimeve të biznesit janë të domosdoshme për marrjen e vendimeve të informuara dhe përkrahjen e investitorëve, rregullatorëve dhe palëve të tjera. Regjistrat dhe shënimet tona duhet të pasqyrojnë saktë dhe drejt transaksionet tona, me hollësi të mjaftueshme dhe në pajtim me praktikat dhe politikat e kontabilitetit.

Disa punonjës kanë përgjegjësi të veçantë në këtë fushë, por të gjithë ne kontribuojmë në procesin e regjistrimit të rezultateve afariste ose në mirëmbajtjen e shënimeve. Sigurohuni që informatat që regjistrujmë të jenë të sakta, të mblidhen në kohë, të jenë të plota dhe të mirëmbahen në pajtim me mekanizmat tona të kontrollit të brendshëm, mekanizmat e shpalosjes së informatave dhe detyrimet tona ligjore.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Mbani shënime biznesi në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë të vërtetën e ngjarjes ose transaksionit në fjalë. Udhëhiquuni nga parimet e transparencës dhe vërtetësisë.
- Shkruani me kujdes të gjitha komunikimet tuaja afariste. Shkruani sikur një ditë regjistrimet që ju krijoni të bëheshin dokumente publike (duke përfshirë këtu edhe korrespondencën e postës elektronike).

Bëni kujdes me

- Shënimet që nuk janë të qarta dhe të plota ose që fshehin natyrën e vërtetë të ndonjë veprimi.
- Fondet, asetet ose detyrimet e pashpalosura ose të pambajtura shënim.

- Shkatërrimin e papërshtatshëm të dokumenteve (duke përfshirë dokumentet që duhet të ruhen me urdhër gjyqësor).

Po sikur...?

Në fund të tremujorit të periudhës së kaluar të raportimit, mbikëqyrësi më kërkoi të mbaja shënim shpenzime shtesë edhe pse ne furnitori nuk na i ka dërguar faturat dhe puna nuk ka nisur ende. Unë rashë dakord t'i mbaja shënim, meqenëse të gjithë ishim të sigurt që puna do të kryhen gjatë tremujorit të radhës. Tani pyes veten nëse kam bërë gjënë e duhur.

Jo, nuk keni bërë gjënë e duhur. Kostot duhet të regjistrohen në periudhën kur kanë ndodhur. Në datën kur ju regjistruat transaksionin, puna nuk kishte filluar dhe nuk kishte pasur kosto. Prandaj, kjo ka qenë deklaratë e rreme dhe, në varësi të rrethanave, mund të cilësohet madje edhe si mashtrim.

Mbajtja e regjistrimeve korporative

Dokumentet duhet të sistemohen vetëm në pajtim me politikat e kompanisë “Joyson Safety Systems” dhe nuk duhet të shkatërrohen ose fshihen kurrë. Nuk duhet të mbuloni kurrë veprimet e gabuara ose të lejoni të tjerët të veprojnë kështu. Kurrë mos i shkatërroni dokumentet si përgjigje ndaj ndonjë hetimi ose auditimi apo për t’iu paraprirë këtyre.

Nëse keni pyetje ose shqetësime lidhur me mbajtjen ose shkatërrimin e regjistrimeve korporative, jeni të lutur të kontaktoni me Departamentin Ligjor.

Komunikimi me publikun

Ne jemi zotuar të mbajmë komunikim të sinqertë, profesional dhe të ligjshëm, brenda kompanisë dhe në raport me publikun. Ne komunikojmë me saktësi me publikun, zyrtarët dhe mediat.

Ne kemi nevojë për një zë të qëndrueshëm kur shpalojmë informata ose kur i japim informata publikut. Për këtë arsye, është e rëndësishme që në emër të kompanisë “Joyson Safety Systems” të flasim vetëm personat e autorizuar. Komunikimet me mediat, investitorët, analistët e bursës dhe anëtarë të tjerë të komunitetit financiar, duhet t’i referohen menaxhmentit ekzekutiv. Punonjësit duhet të sigurojnë miratimin e Departamentit Ligjor përpara se të publikojnë informata afariste.

Bëni kujdes me



- Mbajtjen e fjalimeve publike, shkrimin e artikujve për gazeta profesionale ose me mjete të tjera të komunikimit me publikun, që ndërlidhen me kompaninë “Joyson Safety Systems”, pa miratimin paraprak të menaxhmentit.
- Tundimin për të përdorur titullin ose lidhjet jashtë punës që kryeni për kompaninë “Joyson Safety Systems”, pa ua bërë të tjerëve të qartë se këtë e përdorni vetëm për qëllime identifikimi.
- Ftesat për t’iu dhënë “deklarata jozyrtare” gazetarëve ose analistëve që ju kërkojnë informata lidhur me kompaninë “Joyson Safety Systems” ose klientët apo partnerët e biznesit të kompanisë.

Përdorimi i medieve sociale

Bëni kujdes kur shkruani korrespondenca që mund të publikohen në internet. Nëse merrni pjesë në ndonjë grup diskutimi në internet, dhoma bisedash të lira (chat), tabela shpalljesh, blogje, sajtet e medieve sociale ose komunikime të tjera elektronike, madje edhe nën pseudonime, kurrë mos jepni përshtypjen se po flisni në emër të kompanisë “Joyson Safety Systems”.

Nëse mendoni se është publikuar ndonjë deklaratë e rreme lidhur me kompaninë tonë, mos postoni dhe mos shpërndani informata jopublike, edhe nëse qëllimi juaj është “t’i vini gjërat në vendin e vet”. Fakti që ju postoni mund të keqinterpretohet, duke nxitur thashetheme të pavërteta ose mund të jenë të pasakta ose devijuese. Në vend që të veproni kështu, kontaktoni me Departamentin Ligjor.

Respektimi i tekstit dhe frymës së ligjit



Parimet “antitrust” dhe konkurrenca e ndershme

Ne besojmë në konkurrencën e lirë dhe të hapur dhe kurrë nuk merremi me praktika të pandershme për të kufizuar konkurrencën. Ne kurrë nuk kërkojmë të sigurojmë avantazhe konkurruese përmes praktikave afariste jo etike ose të paligjshme.

Ligjet “antitrust” përbëjnë kërkesa komplekse pajtueshmërie që mund të variojnë në varësi të rrethanave, por në përgjithësi aktivitetet e mëposhtme janë “alarme të kuqe” dhe duhet të shmangen. Nëse zbulohen, ato duhet t’i raportohen Departamentit Ligjor:

- Shkëmbimi me një konkurrent i informatave të kompanisë që janë të ndjeshme nga aspekti i konkurrencës.
- Shkëmbimi i informatave të partnerëve afaristë ose palëve të tjera të treta, informata këto të ndjeshme nga aspekti i konkurrencës, me konkurrentët e tyre.
- Përpjekja për të siguruar informata jopublike lidhur me konkurrentët nga punonjësit e rinj apo kandidatët që kërkojnë të hyjnë në marrëdhënie pune.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Mos lidhni marrëveshje me konkurrentët ose palët e tjera për t’u angazhuar në ndonjë sjellje jonkonkurruese, ku përfshihet caktimi i çmimeve ose ndarja mes njeri-tjetrit e klientëve, furnitorëve ose tregjeve.
- Mos u angazhoni me konkurrentët me biseda rreth informatave të ndjeshme nga aspekti i konkurrencës.

Bëni kujdes me

- Përplasjen, e cila ndodh kur kompanitë komunikojnë ose arrijnë marrëveshje të fshehta lidhur me mënyrën se si do të konkurrojnë. Këtu mund të përfshihen marrëveshjet ose shkëmbimet e informacioneve lidhur me çmimet, kushtet, pagat ose alokimin e tregjeve.
- Manipulimin e tenderëve, i cili ndodh kur konkurrentët ose ofruesit e shërbimeve manipulojnë tenderin në mënyrë që të kufizojnë konkurrencën e ndershme. Këtu mund të përfshihet

krahasimi i ofertave të tenderit, arritja e marrëveshjeve për të hequr dore nga ofertimi ose dorëzimi i qëllimtë i ofertave jokonkurrese.

- Detyrimin, i cili ndodh kur një kompani që ka fuqi tregu i detyron klientët të pranojnë shërbime ose produkte që ata nuk i duan ose që nuk iu nevojiten.
- Çmimet grabitqare, ndodhin atëherë kur një kompani që ka fuqi tregtare e shet një shërbim nën kosto për të eliminuar ose dëmtuar një konkurrent, me qëllim që të rikuperojë humbjet e të ardhurave më vonë, duke i ngritur çmimet pasi ta ketë eliminuar ose dëmtuar konkurrentin.

Po sikur...? Në një seminar të një OEM-je, ndërsa po bisedoj me një ish-koleg, i cili tani punon për një konkurrent, ai me thotë se fitimi i biznesit me “OEM-X”-in është një prej prioriteteve të tij. Ai më pyet nëse kompania “Joyson Safety Systems” planifikon të ofertojë agresivisht në RFQ-në e ardhshme për “OEM-X”-in. Çfarë duhet të bëj?

Mos komentoni për planet e kompanisë “Joyson Safety Systems”. Pohoni qartë që nuk dëshironi të merrni asnjë informatë konfidenciale lidhur me strategjinë tregtare të konkurrentit dhe njoftojeni menjëherë zyrtarin e pajtueshmërisë për këtë incident.

Po sikur...? Më telefonon një konkurrent që dëshiron të diskutojë lidhur me rritjen e kostove materiale të kohëve të fundit. Ai ankohet se “OEM-X”-i refuzon të pranojë çdo lloj rritjeje çmimi pavarësisht rritjes së madhe të kostove dhe se kjo po ia dëmton marzhat. Ai sugjeron që të marrim një pozitë të përbashkët në kuadrin e negociatave me “OEM-X”-in për të siguruar që rritja e kostove materiale t’i “faturuhet” klientit. Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet të pohoni qartë se nuk dëshironi të diskutoni “faturimin” e rritjes së kostove materiale klientëve ose ndonjë aspekt tjetër të kushteve ose çmimeve të klientit. Më pas, përfundojeni telefonatën dhe njoftojeni menjëherë zyrtarin e pajtueshmërisë për këtë incident.

Po sikur...? Më kanë dërguar informata të ndjeshme nga aspekti i çmimeve, nga njëri prej konkurrentët tanë. Çfarë duhet të bëj?

Duhet të kontaktoni menjëherë zyrtarin e pajtueshmërisë, përpara se të ndërmerret ndonjë veprim tjetër. Është e rëndësishme që, që nga momenti kur neve na vijnë këto informata, të demonstrojmë se i respektojmë ligjet “anti-trust” dhe t’ua bëjmë të qartë të tjerëve se presim që edhe ata të bëjnë të njëjtën gjë. Për ta bërë këtë, duhet të ndërmerren veprimet e duhura, të cilat përcaktohen sipas rastit. Në kuadrin e këtyre veprimeve mund t’i dërgojmë një letër konkurrentit.

Për më shumë informacione, ju lutemi referohuni udhëzuesit të ligjit për konkurrencë.

SHIKO ME SHUME

- Politika fer e konkurimit.

Bashkëpunimi me auditorët

Nga të gjithë punonjësit pritet të bashkëpunojnë plotësisht me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm, të cilët kryejnë auditime me kërkesë të kompanisë sonë. Krahas kësaj, në kuadrin e veprimtarive afariste, mund të merrni pyetje zyrtare ose kërkesa nga zyrtarë qeveritarë.

Nga ju pritet që të bashkëpunoni plotësisht dhe të siguroni që çdo e dhënë që ju jepni të jetë e vërtetë, e saktë dhe e plotë. Nëse viheni në dijeni për ndonjë hetim të mundshëm qeveritar ose kërkesë për të dhëna nga ana e qeverisë, atëherë njoftoheni menjëherë menaxherin dhe Departamentin Ligjor përpara se të ndërmerrni ose premtoni se do të ndërmerrni ndonjë veprim.

Bëni kujdes me

- Të dhënat false. Kurrë mos shkatërroni, ndryshoni ose fshihni asnjë dokument si parapritje ose përgjigje ndaj një kërkesë për këto dokumente.
- Ndikimet e kundërligjshme. Kurrë mos ofroni ose mos u përpiqni të ndikoni të tjerët për t'i dhënë deklaratat të paplota, të rreme ose çorientuese një kompanie apo hetuesi qeveritar.

Mbrojtja e të dhënave

Ne i respektojmë të dhënat personale të të tjerëve. Ndiqni politikat tona dhe të gjitha ligjet në fuqi gjatë mbledhjes, përpunimit, përdorimit, ruajtjes, bashkëndarjes dhe sistemimit të të dhënave të ndjeshme dhe gjatë qasjes në këto të fundit. Përdorini – dhe ndajini me palë të tjera jashtë kompanisë “Joyson Safety Systems” – vetëm për qëllime afariste legjitime. Lidhur me problematikat e mbrojtjes së të dhënave duhet të këshilloheni me Departamentin Ligjor.

Sigurohuni që ta dini se çfarë lloji informacioni konsiderohet “e dhënë personale”. Këtu përfshihet çdo gjë që mund të përdoret për të identifikuar dikë, goftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, p.sh. Emri, adresa e postës elektronike, numri i telefonit ose numri i kartës së kreditit.

Bëni kujdes me

- Dërgimin e informatave të ndjeshme te makinat e faksit ose printerët e pambikëqyrur.
- Mosgrirjen e kopjeve të shtypura ose mos sistemimin si duhet të informatave të ndjeshme.
- Përdorimin e hostimit në internet, bashkëpunimit ose shërbimeve të resë kompjuterike, të cilat janë falas ose blihen individualisht.

SHIKO ME SHUME

- Politika për mbrojtjen e të dhënave

Veprimtaritë politike

Ju keni të drejtë të merrni pjesë vullnetarisht në proceset politike, duke përfshirë dhënien e kontributeve personale në politikë. Megjithatë, ju duhet ta bëni gjithmonë të qartë që pikëpamjet dhe veprimet tuaja nuk janë pikëpamjet dhe qëndrimet e kompanisë “Joyson Safety Systems” dhe të mos përdorni kurrë paratë e kompanisë për çfarëdolloj qëllimi politik pa marrë autorizimin përkatës.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Sigurohuni që pikëpamjet dhe veprimtaritë tuaja personale politike të mos shihen sikur të ishin të kompanisë.
- Mos përdorni burimet ose ambientet tona për të mbështetur aktivitetet tuaja personale politike.

Bëni kujdes me

- Lobimin. Ndërveprimet me zyrtarët qeveritarë ose entet rregullatore, të cilat mund të shihen si lobim, duhet të diskutohen paraprakisht dhe të koordinohen me zyrtarin e pajtueshmërisë.
- Presionin. Kurrë mos ushtroni presion të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një punonjës tjetër për ta detyruar të kontribuojë, mbështesë ose kundërshtojë ndonjë kandidat ose parti politike.
- Ndikimin e gabuar. Shmangni madje edhe dhënien e përshtypjes se po jepni kontribute politike ose për bamirëse me qëllim që të fitoni favore ose si përpjekje për të ushtruar ndikim të gabuar.
- Konfliktin e interesit. Mbajtja e një zyre politike ose bërja e fushatave për të marrë pozicione politike nuk duhet të krijojë, ose të japë përshtypjen se krijon, konflikt interesi me detyrat në kompaninë “Joyson Safety Systems”.

Po sikur...?

Do të marr pjesë në një eveniment për mbledhje fondesh për një kandidat që po garon në zgjedhje për një post lokal. A përbën problem të përmend pozicionin tim në kompaninë “Joyson Safety Systems” për atë kohë sa nuk përdor asnjë prej fondeve ose burimeve të kompanisë?

Po. Do të ishte veprim i pavend ta lidhni emrin tonë në ndonjë mënyrë me aktivitetet politike tuaja personale.

Po sikur...?

Dëshiroj të ftoj një zyrtar të zgjedhur për të folur në një eveniment që do të organizojë kompania së afërmi. Çfarë problemi mund të kishte kjo?

Ju duhet të merrni miratimin e zyrtarit të pajtueshmërisë përpara se ta ftoni zyrtarin e zgjedhur ose ndonjë zyrtar tjetër qeveritar për të marrë pjesë në një eveniment të kompanisë. Nëse i ftuari është në mes të fushatës së zgjedhjeve, eventimenti i kompanisë mund të shihet si përkrahje e saj për fushatën e kandidatit. Në varësi të ligjeve lokale, çdo ushqim, pije ose transporti që i ofrohen të ftuarit do të mund të konsiderohen si dhuratë. Në shumicën e rasteve, do të ketë kufizime dhe detyrime për raportim.

Spekulimi me informacion të brendshëm

Gjatë aktiviteteve afariste, ju mund të mësoni informata konfidenciale për kompaninë “Joyson Safety Systems” ose për kompani të tjera publike, të cilat nuk janë të disponueshme për publikun e gjerë. Tregtimi i letrave me vlerë duke qenë i informuar për këto informata materiale jopublike, ose shpalosja e këtyre informatave ndaj palëve të tjera, të cilat më pas zhvillojnë tregti (“bakshish”), ndalohen me ligje të ndryshme.

Informatat materiale

Informatat materiale janë lloj informatash që një investitor, në mënyrë të arsyeshme, do të merrte në konsiderate gjatë marrjes së vendimit lidhur me atë nëse do të blinte apo shiste një letër me vlerë. Disa shembuj të informatave për kompaninë, të cilat mund të jenë materiale, janë:

- Propozimi për blerjen ose shitjen e një biznesi.
- Zgjerimi domethënës ose shkurtimi i operacioneve.
- Zhvillimi i një produkti të rëndësishëm ose informatat e rëndësishme për një produkt.
- Menaxhimi i jashtëzakonshëm ose zhvillimet afariste.
- Ndryshimet në drejtimin strategjik, si p.sh. hyrja në tregje të reja.

SHIKO ME SHUME

- Politika për tregoviti e mbredeshme.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Mos i blini dhe mos i shitni letrat me vlerë të asnjë kompanie në rastet kur keni informata materiale jopublike rreth asaj kompanie.
- Mbrojini informatat materiale jopublike nga publiku i përgjithshëm, duke përfshirë këtu edhe informatat në formë elektrike dhe të shtypur.
- Diskutoni me Departamentin Ligjor çdo pyetje ose shqetësim rreth spekulimit me informacion të brendshëm.

Bëni kujdes me

- Kërkesat e miqve ose anëtarëve të familjes për informata rreth kompanive me të cilat ne bëjmë biznes ose për të cilat kemi informata. Edhe bisedat e zakonshme mund të shihen si “bakshish” i paligjshëm i informatave të brendshme.

- Bashkëndarjen e informatave materiale jopublike me cilindo, qoftë me qëllim apo pa dashje, përveç nëse kjo bashkëndarje është e domosdoshme për aktivitetet afariste që kanë të bëjnë me kompaninë “Joyson Safety Systems”. Dhënia e këtyre informatave personave të tjerë të cilët mund të marrin një vendim për të investuar, duke u mbështetur në informatat tuaja të brendshme konsiderohet si “bakshish” dhe shkel ligjin, pavarësisht nëse ju përfitoni apo jo nga tregtimi i tyre.

Lufta ndaj korrupsionit dhe ryshfetit

Ne besojmë se të gjitha format e ryshfetit dhe praktikave të tjera korruptuese janë një mënyrë e papërshtatshme për të kryer aktivitete afariste, pavarësisht zakoneve vendore. Kompania “Joyson Safety Systems” është e zotuar të veprojë në pajtim me të gjitha ligjet e zbatueshme për parandalimin e korrupsionit.

Ne nuk japim dhe as nuk pranojmë ryshfet, përçindje mbi fitimin apo pagesa për lehtësim, në asnjë kohë dhe për asnjë shkak. Kjo vlen njëllor për çdo person ose firmë që përfaqëson kompaninë “Joyson Safety Systems”. I vetmi përjashtim i mundshëm është nëse një pagesë që normalisht mund të jetë e pavend, është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin ose sigurinë e një individi. Në një situatë të tillë, ju duhet t’ia raportoni pagesën menjëherë zyrtarit të pajtueshmërisë.

Përkufizimet kyçe – ryshfeti, korrupsioni, pagesat për lehtësim

“**Ryshfeti**” nënkupton dhënien ose marrjen e çfarëdolloj gjëje të çmuar (ose ofrimi i saj) për të siguruar ose ruajtur një avantazh afarist, financiar ose tregtar.

“**Korrupsioni**” është abuzimi i dikujt me kompetencat që i janë dhënë, për të siguruar përfitime private.

“**Pagesat për lehtësim**” – në disa vende, kompanitë e kanë zakon të paguajnë punonjësit qeveritarë të nivelit të ulët që të përshpejtojnë ose lehtësojnë kryerjen e veprimeve qeveritare rutinore dhe jodiskrecionale, të tilla si: sigurimi i licencës ose lejes së zakonshme të biznesit ose përpunimi i dokumenteve qeveritare siç janë vizat. Këto pagesa në përgjithësi njihen si “pagesa për lehtësim” dhe ndonëse mund të jenë pjesë e zakonit në disa vende të caktuara në botë, ato mund të shkelin ligjin në fuqi, prandaj ne i ndalojmë këto pagesa, me përjashtim të rasteve që kanë të bëjnë me shëndetin ose sigurinë personale të punonjësve tanë.

Është shumë e rëndësishme që të jemi syçelë dhe të monitorojmë me kujdes palët e treta që veprojnë në emrin tonë. Ne i shqyrtojmë me kujdes të gjitha palët e treta, ku përfshihen furnitorët, konsulentët dhe ofruesit e shërbimeve të cilët punojnë në emër të kompanisë, sidomos kur veprojmë në vende ku korrupsioni është në nivele të larta dhe në çdo situatë ku “alarmet e kuqe” do të tregonin nevojën për shqyrtime të mëtejshme përpara se të vazhdohet puna me palën e tretë. Palët e treta duhet të kuptojnë se iu kërkohet të veprojnë duke respektuar rreptësisht standardet tona dhe të mbajnë shënime të sakta për të gjitha transaksionet.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Kurrë mos jepni asnjë zyrtari qeveritar asgjë të çmuar, në kundërshtim me ligjet lokale dhe rregulloret. Nëse nuk jeni të sigurt se çfarë parashikojnë ligjet lokale, veprimi më i mirë që mund të bëni është të mos jepni asgjë që ka çmuar.
- Kuptojini standardet që parashikohen me ligjet kundër ryshfetit, të cilat vlejnë për rolin që ju luani në kompaninë “Joyson Safety Systems”.
- egjistrojini me përpikëri dhe plotësi të gjitha pagesat e kryera ndaj palëve të treta.

Bëni kujdes me

- Shkeljet e dukshme të ligjeve për parandalimin e ryshfetit nga ana e partnerëve tanë të biznesit.
- Agjentët që nuk dëshirojnë t’i kenë të dokumentuara qartë me shkrim të gjitha kushtet e angazhimit të tyre në kompaninë “Joyson Safety Systems”.

SHIKO ME SHUME

- Politika kundër korrupsionit.
- Politika për dhuratat dhe manifestimet.

Po sikur...? Unë punoj me një agjent të huaj, në kuadrin e operacioneve që zhvillojmë në një vend tjetër. Dyshoj se një pjesë e parave që i paguajmë atij përdoren si pagesa ose ryshfete për zyrtarët qeveritarë. Çfarë duhet të bëj?

Këtë çështje duhet t'ia raportoni për hetim zyrtarit të pajtueshmërisë. Nëse ka ryshfet dhe ne nuk veprojmë, si ju, ashtu edhe kompania juaj, mund të mbajnë përgjegjësi ligjore. Edhe pse hetimi i këtyre çështjeve, në disa vende, mund të jetë i vështirë nga aspekti kulturor, çdo agjent që bën biznes me ne duhet të kuptojë domosdoshmërinë e marrjes së këtyre masave. Është e rëndësishme dhe me vend që t'ua kujtojmë agjentëve tanë këtë politikë.

Parandalimi i pastrimit të parave

Pastrimi i parave është një problem botëror, pasojat e të cilit janë të gjera dhe serioze. Ai përkufizohet si proces i shndërrimit të të ardhurave të paligjshme në mënyrë të tillë që fondet të duken sikur janë të fituara në rrugë ligjore. Ky proces nuk kufizohet vetëm te transaksionet e parave të gatshme. Përfshirja në këto aktivitete minon integritetin tonë, dëmton reputacionin dhe mund ta ekspozojë kompaninë dhe individët e përfshirë ndaj sanksioneve të rënda. Raportoni çdo transaksion dhe aktivitet financiar të dyshimtë te zyrtari i pajtueshmërisë dhe, nëse paraqitet nevoja, te agjencitë përkatëse qeveritare.

Importet, eksportet dhe tregtia globale

Kompania “Joyson Safety Systems” ka aktivitete afariste në të gjithë botën përmes të cilave mbështet një bazë klientësh nga e gjithë bota, të cilët shtohen gjithmonë e më shumë. Për të ruajtur dhe rritur pozicionin tonë global, të gjithë punonjësit tanë, zyrtarët dhe drejtorët duhet t'i përmbahen me rreptësi jo vetëm ligjeve të Shteteve të Bashkuara, të cilat udhëheqin importimin, eksportimin dhe riekportimin e produkteve tona, por edhe ligjet e vendeve të tjera ku prodhohen, riparohen ose përdoren produktet tona. Çdo shkelje e këtyre ligjeve, madje edhe nga padija, mund të dëmtojë dhe të ketë ndikime afatgjata në biznesin tonë.

Nëse në përgjegjësitë tuaja bëjnë pjesë eksportimi i produkteve ose pranimi i produkteve të importuara, ju jeni përgjegjës për shqyrtimin e klientëve, furnitorëve dhe transaksioneve, me qëllim që të garantoni që ne respektojmë të gjitha kërkesat në fuqi për eksportin dhe importin.

Rregulloret për parandalimin e bojkotit

Ne i respektojmë ligjet tregtare të të gjitha vendeve ku bëjmë biznes, duke përfshirë ligjet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në bojkote ndërkombëtare dhe ato që ndalojnë transaksionet me vende, persona juridikë ose njerëz specifikë.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Siguroni të gjitha licencat e nevojshme përpara se të eksportoni ose riekportoni produktet, shërbimet ose teknologjitë.
- Raportoni informata të plota, të përpikta e të hollësishme lidhur me çdo produkt të importuar, duke përfshirë vendin (vendet) e prodhimit dhe koston e tij të plotë.
- Drejtojani Departamentit Ligjor çdo pyetje që mund të keni lidhur me importimin ose eksportimin e produkteve tona, pjesëve ose teknologjive.

Bëni kujdes me

- Transferimin e të dhënave teknike dhe teknologjisë të dikush në një vend tjetër, përmes rrugëve të tilla si: posta elektronike, bisedat, takimet ose qasja në bazën e të dhënave. Ky kufizim vlen për bashkëndarjen e informatave me kolegët dhe me personat që nuk janë punonjës.
- Transportimin drejt një vendi tjetër të aseteve të kompanisë, të cilat përmbajnë teknologji të caktuar (për shembull, kompjuteri që merr një bashkëpunëtor me vete gjatë një udhëtimi afarist).



Po sikur...?

Puna ma kërkon që të ndërveproj rregullisht me zyrtarët e doganave. Në kuadrin e punës, më kërkohet rregullisht t'i ofroj shërbimit të doganës informata lidhur me importet dhe eksportet. A duhet patjetër ta kontaktoj Departamentin Ligjor çdo herë, përpara se t'i dërgoj qeverisë informata?

Qasja e duhur në këtë rast do të ishte që të diskutoni me Departamentin Ligjor lidhur me llojet e kërkesave që departamenti juaj merr në mënyrë rutinore nga dogana. Këto kërkesa rutinore, sapo të kuptohen, mund të menaxhohen pa asnjë shqyrtim ligjor. Megjithatë, në rastin e kërkesave të jashtëzakonshme, Departamenti Ligjor duhet të kryejë një shqyrtim për të garantuar që ju po përgjigjeni saktë, plotësisht dhe në harmoni me ligjin.

Në shërbim të

më të mirës



Respektimi i të drejtave të njeriut

Ne i kryejmë veprimtaritë afariste në mënyrë të tillë që të respektojmë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e të gjithëve. Gjithashtu, përkrahim përpjekjet ndërkombëtare për të nxitur dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe kundërshtimin absolut ndaj skllavërisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Secili prej nesh mund të ndihmojë në mbështetjen e përpjekjeve për të eliminuar abuzime të tilla si: puna e fëmijëve, skllavëria, trafikimi i qenieve njerëzore dhe puna e detyruar.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Raportoni çdo dyshim apo provë të abuzimit me të drejtat e njeriut në operacionet tona ose në operacionet e furnitorëve tanë.
- Mbani parasysh që respektimi i dinjitetit njerëzor fillon me ndërveprimet tona të përditshme me njeri-tjetrin dhe me furnitorët dhe klientët tanë. Këtu përfshihet nxitja e diversitetit, akomodimi i aftësive të kufizuara dhe përpjekjet nga ana jonë për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e të gjithëve atyre me të cilët bëjmë biznes.

Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve dhe mineraleve në zonat e konflikteve

Të ardhurat nga materialet në zonat e konflikteve mund të lidhen me financimin e grupeve që përfshihen në dhunë ekstreme dhe vepra kriminale kundër të drejtave të njeriut, prandaj ne jemi proaktivë dhe zbatojmë politika dhe procedura në të gjithë zinxhirin tonë të furnitorëve për të shfrytëzuar burimet në mënyrë të përgjegjshme, për të monitoruar performancën e furnitorëve tanë dhe, aty ku paraqitet nevoja, për të kërkuar ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese.

Ne punojmë për së afërmi me furnitorët e lëndës së parë, pjesëve dhe përbërësve, dhe i komunikojmë pritshmërinë tonë që furnitorët dhe ofruesit e shërbimeve të respektojnë të gjitha ligjet në fuqi, duke përfshirë këtu edhe ligjet që kanë të bëjnë me ofrimin e mineraleve që nxirren nga vende që nuk janë në konflikt.

Mbrojtja e mjedisit

Ne i njohim përgjegjësitë tona në raport me mjedisin dhe shoqërinë. Ne jemi të zotuar për qëndrueshmëri dhe minimizim të dëmtimit të mjedisit si dhe çdo dëmtimi të mundshëm të shëndetit dhe sigurisë së punonjësve, klientëve dhe publikut.



Ndiqni parimet tona udhëheqëse

- Bëni pjesë tuaj për të siguruar që ruajtja e sigurisë së punonjësve dhe e mjedisit është prioritet. Ndaloni punën dhe raportoni çdo situatë që besoni se mund të çojë në krijimin e kushteve të pasigurta të punës ose dëmtimin e mjedisit.
- Lexoni dhe kuptoni të gjitha informatat që ju jep kompania, në lidhje me vendin e punës, shëndetin dhe sigurinë tuaj dhe ndikimet e operacioneve tona në mjedis.
- Merrni pjesë plotësisht në trajnimet për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe bashkëpunoni në shqyrtimet periodike të pajtueshmërisë, të cilat kryhen nga kompania jonë, për produktet dhe operacionet tona.
- Jini proaktivë dhe kërkoni mënyra për të minimizuar mbetjet, konsumin e energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore.
- Kontaktoni me zyrtarin e pajtueshmërisë nëse keni ndonjë pyetje për pajtueshmërinë me ligjet dhe politikat për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë.

Mendimet përmbyllëse të zyrtarit tonë të pajtueshmërisë

Si punonjës, ju jeni aseti ynë më i vlefshëm.

Ju jeni kompania “Joyson Safety Systems”. Ju jeni fuqia “shtytëse” prapa produkteve tona dhe klientëve të cilëve iu shërbejmë. Ju jeni pjesë e një ekipi që i sjell tregut të punës shpirtin sipërmarrës dhe teknologjinë novatore. Dhe ju jeni çdo ditë në front për të siguruar që ne t’i qëndrojmë zotimit tonë të palëkundur për të shpëtuar jetë.

Ju nxis të lexoni Kodin tonë dhe t’i drejtoheni atij shpesh. Kodi nuk është libër me rregulla, por udhëzues për të bërë gjërat e duhura në mënyrën e duhur, duke ruajtur reputacionin që kemi fituar si kompani që jo thjesht sjell ndryshime, por i sjell ndryshimet duke ruajtur integritetin.

Zyrën time shiheni si burimin dhe parterin tuaj në kuadrin e kryerjes së aktiviteteve afariste me ndershmëri dhe etikë dhe në pajtueshmëri me ligjet. Ngrini zërin për çdo sjellje që mund ta vërë në rrezik reputacionin tonë, për të cilin kemi punuar fort, dhe sa herë që merrni vendim pyesni veten: “A po i respektoj unë “Parimet udhëheqëse”?”

Kur i respektoni këto parimi, nderoni edhe trashëgiminë që kanë lënë pas punonjësit para jush dhe shtroni rrugën për ata që do të vijnë më vonë. Gjithashtu, ju ndihmoni edhe për të garantuar sigurinë e klientëve të kompanisë “Joyson Safety Systems” në të gjithë botën.

